

VENDIM
Nr. 118, datë 4.6.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SONNE” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
TOPOJË, ME FUQI TË INSTALUAR 1998 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a” dhe neni 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 1.2.2018, protokolluar në ERE me nr. 149 prot., datë 2.2.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 7.3.2018, vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 kw, për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar.

- Me shkresën nr. 6 Prot., datë 30.3.2018, dhe protokolluar në ERE me nr. 149/3 prot., datë 3.4.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka riaplikuar për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Në nenin 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.”

- Rezulton se aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda afateve të parashikuara në dispozitat më sipër.

- Shoqëria “SONNE” sh.p.k. ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën me nr. 2278 rep. dhe nr. 1052/3 kol., datë 12.10.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë”, me kapacitet prodhues 1998 kw, në Bashkinë Fier, qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 20.4.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier me kapacitet të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.

- Me shkresën nr. 55/19 prot., datë 24.4.2018, është bërë njoftimi në median e shkruar, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik dhe pas përfundimit të afatit 20-ditor të paraqitjes së objeksioneve ose ankesave, lidhur me këtë aplikim, nuk rezulton të jetë depozituar në ERE asnjë ankesë ose objeksion.

- Aplikimi i shoqërisë “SONNE” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germet “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 - Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
 - Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti